

**Nr. Prot.122/B/19.**

**VENDIMI Nr. 1477**

**Për**

**Miratimin e 'Rregullores për Ofrimin e Shërbimeve Universale Postare'**

Në mbështetje të nenit 4, paragrafi 1), nenit 7 paragrafi 2.1) dhe paragrafi 2.2), nenit 8, nenit 10, nenit 11, dhe nenit 12, të Ligjit Nr. 06/L-38, për Shërbime Postare, (*tutje referuar si - Ligji*), nenit 79 paragrafi 1) dhe 2) të Ligjit Nr. 04/L-109, për Komunikime Elektronike, dhe nenit 13, paragrafi 1), dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), Bordi i Autoritetit në përbërje nga:

- 1) z. Kreshnik GASHI, Kryetar i Bordit,
- 2) z. Nijazi ADEMAJ, Anëtar i Bordit,
- 3) z. Hazir HAJDARI, Anëtar i Bordit,
- 4) z. Bahri ANADOLLI, Anëtar i Bordit.

në mbledhjen e 51-të, me rradhë të mbajtur më datë; 22.11.2019, pas shqyrtimit të materialeve dhe dokumentacionit të përgatitura nga Sektori i Shërbimeve Postare (SSHP), dhe Departamenti Ligjor (DL), unanimisht mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet '**Rregullorja për Ofrimin e Shërbimeve Universale postare**';
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Qëllimi i kësaj Rregullore, është vendosja e rregullave, përcaktimi i procedurave dhe kushteve të ofrimit të shërbimeve universale postare, në Republikën e Kosovës, nga ndërmarrësit që ofrojnë shërbime universale postare, nën kushtet e 'Autorizimit Individual'.

Neni 7, paragrafi 2) nën-paragrafi 2.2), i Ligjit, përcaktonë se Autoriteti: *harton dhe miraton rregulloret në zbatim të këtij Ligji, ndërsa nën-paragrafi 2.3) i këtij neni përcakton se Autoriteti; përcakton ofruesin e shërbimit universal postar sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe mbikëqyrë përmbushjen e detyrimeve të shërbimit universal postar;*

Neni 8, përcakton se; *'Autoriteti gjatë procesit të hartimit të akteve nënligjore, të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në tregun e shërbimeve postare, duhet të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesit, nëpërmjet konsultimit publik, sipas procedurave të përcaktuara nga Autoriteti'.*

Neni 11, përcakton se; *Për sigurimin e ofrimit të shërbimit universal postar, Autoriteti cakton një ofrues të shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit universal postar në tërë territorin e Republikës së Kosovës.*

Neni 23, paragrafi 1), i Ligjit përcakton se; *'Autoriteti me vendim të veçantë përcakton ofruesin e shërbimit universal postar, pas përfundimit të procedurave të përcaktuara në aktin e veçantë të miratuar nga Autoriteti.*

Neni 59, paragrafi 3) i ligjit përcakton se; *Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Autoriteti, i jep ofruesit publik të shërbimeve postare, autorizimin individual, si ofrues i shërbimit universal postar, me afat pesë (5) vjeçar në përputhje me këtë ligj.*

Duke pasur parasyshë atë që u tha më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e nxjerrjes së Vendimit.

**Prishtinë, 11/12/2019.**

### **Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

Bordi Drejtues:

1. Nijazi Ademaj, \_\_\_\_\_
2. Hazir Hajdari, \_\_\_\_\_
3. Bahri Anadolli, \_\_\_\_\_

### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Postës së Kosovës SHA,;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/DPT dhe TI;
- Departamentit Ligjor (DL),
- Sektorit të Shërbimeve postare (SSHP),
- Arkivës së Autoritetit.